



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 52/3 prot.

Tiranë më 9.2.2018

URDHËR

Nr. 57, datë 9.2.2018

MBI

FSHIRJEN E PËRPUNIMEVE TË PALIGJSHME TË TË DHËNAVE  
PERSONALE

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.17, datë 12.01.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Përmbaruesit Privat "Ardael" sh.p.k. Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Zyra Përmbarimore Private "Ardael" sh.p.k. Tiranë.

Në funksion të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Zyrat Përmbarimore Private, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe grumbullojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe përmbarues gjyqësor" dhe "subjekte që marrin pjesë në ekzekutim".

Kontrolluesi "Ardael" sh.p.k. është subjekt juridik me NIPT: L22003001R, dhe objekt aktiviteti, "Shërbim përmbarimor privat".

Kontrolluesi "Ardael" sh.p.k. Tiranë, në ushtrim të detyrës së tij, ka kryerjen e shërbimit përmbarimor privat gjyqësor dhe konkretisht, ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Përfaqësuesi i kontrolluesit u njoh me Urdhrin Nr.17, datë 12.01.2018 të Komisionerit dhe ishte bashkëpunues me grupin e inspektimit.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 22.01.2018 u konstatua:**

1. Nga verifikimi në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese të zyrës së Komisionerit është konstatuar se kontrolluesi ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Ky detyrim është realizuar në datë 22.01.2018. Konstatohet se është i nevojshëm përditësimi i Formularit, për shkak se në pikën pesë nuk është përcaktuar përpunimi i të dhënave sensitive.
2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Këtë detyrim kontrolluesi e ka realizuar në datë 22.01.2018.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Në kontratat me palët e treta, për ofrimin e shërbimeve të zyrës përmbartimore në lidhje me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura etj., kontrolluesi aplikon modelin standard të kontratës miratuar nga Ministria e Drejtësisë, konstatohet se në pikën 7 të nenit 6 janë mbajtur parasysh disa nga detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".
5. Kontrolluesi mbikëqyr zyrat ku punonjësit konsumojnë orarin e kryerjes së detyrës dhe ambientet e jashtme nëpërmjet sistemit të video-surveimit. Janë vendosur tabela informuese në hyrje të ambienteve në të cilin kontrolluesi ushtron aktivitetin, por nuk janë sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri nëpërmjet Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera". Këtë mangësi, kontrolluesi e ka rikuperuar në datë 22.01.2018.

Në përfundim të hetimit administrativ pasi u mbajt procesverbali për konstatimet e gjetura nga ana e grupit të hetimit, përfaqësuesi i kontrolluesit u shpreh:

*"Kemi reflektuar me rekomandimet:*

- Janë vendosur tabelat sipas standardit.
- Është bërë rregullorja sipas standardit.
- Kemi deklaruar të konfidencialitetit dhe atë të pëlqimit të kamerave nga punëmarrësit".

Ligji Nr.10 031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat" i ndryshuar dhe konkretisht neni 36 i tij "Konfidencialiteti" shprehet:



*"Përmbaruesi gjyqësor privat, i cili merr informacionet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan fshehtësinë e tyre dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç:*

*a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;*

*b) strukturave të tjera shtetërore, lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;*

*c) përmbaruesve të tjerë, vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;*

*ç) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv;*

*d) kur personi, për të cilin kërkohet informacioni, jep pëlqimin".*

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të kontrolluesit "Ardael" sh.p.k. Tiranë, ndër format e ndryshme të grumbullimit të të dhënave (manuale dhe elektronike), percepton imazhe nga një sistem video-vëzhgimi CCTV, nëpërmjet të cilit mbikëqyr ambientet e brendshme duke përfshirë edhe zyrat ku punonjësit konsumojnë orarin e kryerjes së detyrës. Pavarësisht faktit formal, të dhënies së pëlqimit nga ana e punonjësve të kontrolluesit, kontrolluesi gjendet në kushtet e pikës 10.2 të Udhëzimit Nr.11, datë 08.09.2011 të Komisionerit, mbi "Përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", i cili shprehet:

*"10.2 Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës. Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret në tualete, dhomat e ndërrimit apo vende të tjera të ngjashme, ose në dhomat e punës të caktuara për përdorim personal të punonjësve".*

Konstatimi i shprehur në pikën 5 të procesverbalit, është në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kriterëve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe që konsiston në mbikëqyrjen e ambienteve ku punonjësit ushtrojnë detyrën e tyre.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit reagon me përparësi dhe në mënyrë të menjëhershme me këtë urdhër, në lidhje me fshirjen e të dhënave personale të siguruara në mënyrë të paligjshme si dhe ndërprerjen e mbikëqyrjes nëpërmjet sistemit të kamerave CCTV, në ambientet ku punonjësit konsumojnë orarin zyrtar të punës.

Neni 30, paragrafi 1, germa "b" e ligjit të sipërcituar përcakton se: *"Komisioneri ka këto të drejta: b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale".*

#### **Sa më sipër:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 27, 28, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### **URDHËROJ :**

1. Kontrolluesi, Zyra Përmbarimore Private "Ardael" sh.p.k. Tiranë, të fshijë të gjitha të dhënat personale të siguruara në mënyrë jo të drejtë dhe haptazi të paligjshme, nëpërmjet sistemit video-vëzhgimi CCTV, i cili realizon *mbikëqyrjen e punonjësve*

në vendin e punës. Gjithashtu, të ndërpritet mbikëqyrja nëpërmjet sistemit të kamerave CCTV, në ambientet ku punonjësit konsumojnë orarin zyrtar të punës.

2. Kontrolluesi, Zyra Përmbarimore Private "Ardael" sh.p.k. Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij urdhëri, të ketë realizuar fshirjen e të dhënave sipas pikës 1.
3. Kontrolluesi, Zyra Përmbarimore Private "Ardael" sh.p.k. Tiranë, të rishikojë mjete të tjera të mundshme mbi kontrollin e ambienteve të punonjësve për të finalizuar qëllimin për të cilin është instaluar sistemi video-vëzhgimi CCTV, dhe shmangien e këtij sistemi.
4. Kontrolluesi, Zyra Përmbarimore Private "Ardael" sh.p.k. Tiranë, ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër.
5. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më 9 . 2 .2018.

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

